



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 459/1 Prot

Shkodër më 16.07 2025

V E N D I M

Nr. 13, Datë 16.07.2025

“Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 26, datë 20.12.2024 ”Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtar 2025-2027 ”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 26, datë 20.12.2024 ”Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtar 2025-2027”, bazuar nën 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.115/2024 “Per Buxhetin e Vitit 2025”, nën 46 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKQShkoder nr.26, datë 29.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtar 2025-2027”, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me 17 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,

V E N D O S I:

1. Të miratojë detajimin e fondeve të Shpenzimeve Kapitale të vitit 2026, **Tab. nr.2 e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026**, nga shuma e planifikuar për “Rikonstruksione rrugësh rurale të qarkut”, shuma 6,316,551 lekë të përdoret për investimin “Sistemim-Asfaltim Rruga Kryqëzimi Shkolla 9/vjeçare Bardhaj-Qafë Rrenc, Faza IV”
Ishte
Kap.1 Progr.01110 Art.231 “Rikonstruksione rrugësh rurale të qarkut” shuma 43,780,915 lekë

Behet

Kap.1 Progr.01110 Art.231 "Rikonstruksione rrugësh rrurale te qarkut" shuma 37,464,364 lekë

Kap.1 Progr.01110 Art. "Sistemim-Asfaltim Rruga Kryqëzimi Shkolla 9/vjeçare Bardhaj-Qafë Rrenc, Faza IV" (ndertim, mbikqyrje e kolaudim), shuma 6,316,551 lekë, sipas relacionit bashkangjitë.

2. Të miratojë shtesë fondi në shumën 700,000 lekë për Aktivitetit nr. 21 "Fest-folk 2025", të buxhetit të vitit 2025, sipas relacionit bashkangjite. Për këtë;
Shtohet;
Kap.1,Progr.01110 Art.602 në shumën 700,000 lekë
Pakësohet
Kap.1,Progr.01110 , Art.602 në shumën 250,000 lekë
Kap.1, Progr.01110 , Art.605 në shumën 450,000 lekë
3. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të planifikuara për vitin 2025 për projektin SMARTMOBAIR, si më poshtë;
Shtohet;
Kap.2, Progr.01110 Art.602 ne shumën 500,000 lekë
Pakësohet
Kap.2, Progr.01110 Art.230 ne shumën 500,000 lekë
4. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të vitit 2025 në shumën 180,000 lekë dhe përdorimin e tyre për blerje paisje kondicionerësh për strukturën rezidenciale për PAK"Shtëpi Familje Facibeni".
Shtohet;
Kap.1,Progr.01110 Art.231 "Paisje kondicioneri" në shumën 180,000 lekë
Pakësohet
Kap.1,Progr.01110 , Art.231"Blerje Automjeti" në shumën 180,000 lekë
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
6. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

